



VEPNDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 DDLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROŠEVAC

P.nr.1115/16

24-02-2017 NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari individual Mustaf Tahiri, me sekretaren juridike Drita Ujupi, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga [REDACTED], për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge neni 275 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II. nr. 51-4/16 të datës 23.11.2016, duke vendosur lidhur me kërkesën e prokurorisë për dhënien e urdhrin ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.20.12.2016 mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Ferizaj, PP/II. nr. 51-4/16 të datës 15.12.2016 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED] nga [REDACTED] rr. [REDACTED], i lindur më dt. [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED], i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se prej datës 13.01.2016, në rr. "Shkëlzen Haradinaj" në Ferizaj, gjatë kontrollit nga ana e njësiteve policore i është gjetur një sasi e substances narkotike të llojit marihuana me peshë të përgjithshme 0.22 gram, të cilën substance narkotike i pandehuri e ka poseduar pa autorizim, të cilat i u janë konfiskuar nga ana e Policisë.

me ç'rast ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge neni 275 par.2 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,23,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

GJYKON

Me dënim në gjobë në shumë prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në forma të tjera sipas nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do të llogaritet 1 (një) ditë burg.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afat prej 30 dite nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Konform nenit 275 par.3 të KPRK-së, substance narkotike bimore me ngjyrë të gjelbërt që është kanabis (Marihuanë) që përmbanë Terahidrokanabinol (THC) me peshë 0.22±0.0001 gram, konfiskohet në mënyrë të përhershme.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën, PP/II. nr. 51-4/16 të datës 23.11.2016 ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] për vepër penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge neni 275 par.2 të KPRK-së dhe me datë 15.12.2016 ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1. të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës siq është raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzike nr.AKF/2016-0631/2016-514 i dt.27.04.2016, raporti i oficerit i dt.13.01.2016, deklarata e të pandehurit e dt.13.01.2016, vërtetimi mbi marrjen e sendeve i dt.13.01.2016, si fotodokumentacioni tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konstatoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afat prej 30 dite nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Konform nenit 275 par.3 të KPRK-së, substance narkotike bimore me ngjyrë të gjelbërt që është kanabis (Marihuanë) që përmbanë Terahidrokanabinol (THC) me peshë 0.27 ± 0.0001 gram, konfiskohet në mënyrë të përhershme.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit është marrë në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPP.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P.nr.675/16 dt. 20.12.2016

Sekretare Juridike

Drita Ujupi

Gjyqtari

Mustaf Tahiri



UDHËZIM JURIDIK: Kudër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimin të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhri ndëshkimor merr formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.